

VENDIM
Nr.343, datë 7.10.1997

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË KUVENDIT POPULLOR PËR HETIMIN E
NGJARJEVE TË PERIUdhËS JANAR-QERSHOR 1997

Në mbështetje të neneve 8 dhe 31 të Rregullores së Kuvendit Popullor, me propozim të 16 deputetëve,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijohet komisioni i posaçëm për të ndriçuar ngjarjet që ndodhën në Shqipëri në periudhën janar-qershor 1997.

II. Komisioni i posaçëm përbehet nga 11 deputetë.

III. Përbërja e tij të jetë si vijon:

1. Spartak Ngjela -Kryetar PLL
2. Sokol Hazizi -anëtar PS
3. Spartak Braho -anëtar PS
4. -anëtar PD
5. -anëtar PD
6. Afrim Cenga -anëtar PSD ,
7. Ligoraq Karamelo -anëtar PBDNJ
8. Fatbardh Hushi -anëtar DBSH
9. Vladimir Fejzo -anëtar Qendra Liberale
10. Nikoll Lesi -anëtar i pavarur
11. Maksim Hasani -anëtar i pavarur

IV. Veprimtaria e komisionit rregullohet me ligj të veçantë.

V. Si rregull, në çdo 15 ditë, komisioni njofton Kuvendin Popullor për veprimtarinë dhe ecurinë e punës së tij.

VI. Komisioni e përfundon detyrën brenda muajit janar 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.